

KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES


Nr. 11, datë 08.04.2020

**“Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të anëtarëve të Këshillit
Drejtues dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Sigurimit të
Depozitave gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga
COVID-19”**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 45, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, të nenit 10, pika 6 të Rregullores “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 31.03.2020 “Për trajtimin e përkohshëm financiar mujor të disa funksionarëve dhe nëpunësve të administratës shtetërore gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”, si dhe të shkresës së Kuvendit të Shqipërisë nr. prot 1053, datë 2.04.2020, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19 deri në përfundim të saj, por jo më shumë se afati i përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 31.03.2020, përfitojnë përkatësisht shpërblim mujor dhe pagë mujore neto në masën 50% të atyre aktuale.



KËSHILLI DREJTUES

2. Autorizohet Kryetari i Këshillit Drejtues të informojë Autoritetin Mbikëqyrës dhe Kuvendin e Shqipërisë mbi këtë vendim.
3. Ngarkohen Sektori i Financës dhe Investimeve, si dhe Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar